



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 258, Datë 10.10.2022

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO ENERGY SOTIRA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1755/2 prot., datë 03.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “HYDRO ENERGY SOTIRA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HYDRO ENERGY SOTIRA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1720 prot., datë 17.09.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për t’u licencuar në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: Dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); Dokumentacionin specifik për licencën e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “HYDRO ENERGY SOTIRA” sh.p.k. ka plotësuar kërkesat e rregullores duke dokumentuar informacion në zbatim të nenit 9, pikës 1.1 gërmat “a”, “b”, “c”; pikës 1.2, gërmat “a”, “d”; pikës 1.3, gërma “b” dhe pikës 2.5.
- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:
 - Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*
 - **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë edhe Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore për shoqërinë “HYDRO ENERGY SOTIRA” sh.p.k.
 - **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të informojë ERE-n në lidhje me funksionin që kryejnë operatorët në kuptim të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
 - Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*
 - **gërma “a”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE Vërtetimin e Drejtorisë rajonale të Tatimeve Elbasan në lidhje me shlyerjen e detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
 - **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE edhe planin për tregtimin i cili duhet të përmbajë parashikimin vjetor të kostove, shitjeve dhe të ardhurave për realizimin e kësaj veprimtarie.
- Në lidhje me dokumentacionin e konstatuar të munguar, do të njoftohet shoqëria ta përcjellë atë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HYDRO ENERGY SOTIRA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI